34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimin të përkohshëm.

## **Neni 35 Pranimi përfundimtar**

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimin përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimin do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimin nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimin dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimin. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

## **SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA**

### **Neni 36 Shkelja e kontratës**

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

### **Neni 37 Shkëputja e kontratës**

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

### **Neni 38 Forca madhore**

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

### **Neni 39           Pagesa pas shkëputjes së kontratës**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhësimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

### **Neni 40           Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

### **Neni 41           Lirimi nga Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

## **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

### **Neni 42           Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

### **Neni 43           Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

# KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 613-24-4795-5-2-1/C982

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje 90 ditë, apo shprehur në shifra 10.660.69€.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	<p>Shuma minimale e sigurimit do të jetë</p> <p>(a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit tek kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë;</p> <p>(b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim Pajisjeve të shumta e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre;</p> <p>(c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar.</p> <p>(d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje:</p> <p>(i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar</p> <p>e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar</p>
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është <u>10</u> ditë
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë max 5 ditë pas nënshkrimit të kontratës
Përfundimi i Punimeve	17.2	<p>Data e përfundimit të të gjitha Punëve do të jetë max 60 dite kalendrike pas nënshkrimit të kontratës, rrespektivisht deri më 19.10.2024.</p> <p>Cdo tejkallim apo vonesë pas kësaj date do të zbatohen penalet sipas pikës 19.1 të KVK-së.</p>
Dëmet e likuiduara	19.1	<p>Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% për ditë.</p> <p>Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 20% e Çmimit final të Kontratës.</p>

Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit caktohet Kushtrim Jashanica ndërsa MDMK caktohet Armend Aliu.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: <u>Stk</u>
Pagesa	26.2	Pagesat do të bëhen sipas punëve të përfunduara ne teren dhe të pranuar nga menaxheri i kontratës i cili harton raport me shkrim për punët e përfunduara.
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura: kontraktuesi do te sjelle sigurimin e garancionit mbi kualitetin e punimeve 10% te vleres se kontrates per 1 vit apo 12 muaj i cili do te perdoret per permirsim te defekteve, Certifikata do të lëshohet OE sipas nenit 33 të KPK, në formën e publikuar nga ana e KRPP-së, <b>CERTIFIKATË E PRANIMIT TË PËRKOHSHËM</b> të puneve, njëashtu pas përfundimit afatit të kualitetit OE i lëshohet <b>CERTIFIKATË E PRANIMIT PËRFUNDIMTAR</b> , sipas manualit-doracakut të KRPP-së, i publikuar më dt 08.07.2024,
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 5 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 10% të vlerës së kontratës ne forme te sigurimit (sigurimi mbi kualitetin e punimeve) ne afat 1 vjeçar pas <b>CERTIFIKATË E PRANIMIT TË PËRKOHSHËM</b> .
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është <u>10%</u>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Zyra per Ndermjetesim prane Ministrise se Drejtesise
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <u>gjykata themelore e vendit në pajtim me ligjin në Kosovë</u> .  ose  b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <i>Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</i>



# PARAMASA DHE PARALLOGARIA **SALLA E SPORTIT,** **Gllgoc, LIPJAN - FAZA II**

Vërejtje: Çmimi për çdo pozicion duhet të përfshijë: Blerjen, furnizimin, transportin, punimin dhe montimin, lidhjet sjelljen e pozicionit në gjendje plotësisht funksionale, garancionin si dhe kompletimin e certifikatave dhe atesteve të prodhuesve. Në çmim duhet të kalkulohet gjithashtu i tërë materiali shpenzues deri në lëshuarjen në funksion. Llogaritja e pozicioneve të bëhet sipas gjendjes së realizuar në terren.

**A:**

## PUNËT NDËRTIMORE

Pos	Përshkrimi	Njesia	Sasia	€ /Njësi me TVSH	€/Total me TVSH
<b>1</b>	<b>PUNËT PËRGATITORE</b>				
1.1	Sinjalizimi i punishtese (sipas standarteve te ndërtimit)/hyrje daljeve ne kantier, duke perfshire edhe montimin e tabelës informuese me emrin e projektit, investirotrit, punëkryesit etj.	copë	1	100.0 0	100.00 €
1.2	Furnizimi dhe vendosja e ormanit energjetik per furnizim me rrymë per nevoja të kantierit. Lidhja të bëhet prej KEDS-it, me orën e lajmëruar dhe montuar nga ana e KEDS-it. Pas perfundimit duhet te largohen te gjitha lidhjet e perkohshme dhe të bëhet çlajmërimi i orës elektrike.	copë	1	100.0 0	100.00 €
1.3	Instalimi i perkohëshëm i ujësiellësit, kanalizimit	copë	1	25.00	25.00 €
1.4	Masat mbrojtese dhe percjellese per mbrojtjen e ambientit rrethues.	copë	1	150.0 0	150.00 €
1.5	Punimi i Konstruksionit të PANOSË (Reklamës) me profile të qelikut, me dimensione 250 * 150mm dhe vendosja e sajë sipas udhëzimeve të Organit Mbikeqyres .	copë	1	150.0 0	150.00 €
1.6	Pas përfundimit të punimeve të gjitha ndërtimet e perkohshme duhet të largohen dhe të bëhet pastrimi i ndërtesës si dhe terreni rreth sajë.	copë	1	250.0 0	250.00 €
				<b>Totali</b>	<b>775.00 €</b>

Pos	Përshkrimi	Njesia	Sasia	€ /Njësi	€/Total
<b>2</b>	<b>PUNËT DEMOLUESE</b>				
2.1	Demolimi i gardhit rrethues te shkolles dhe cokkles se betonit, ku do behet lidhja e shkolles me sallën, bartja e mbeturinave deri në deponi.	m'	5	10.00	50.00 €
2.2	Demolimi i kubezave te vjetra parterit, per vendosjen e gypave te hidranteve dhe gypave te nxehmjes duke pasur kujdes për mos dëmtimin e tyre dhe kthimin prap ne vend i tyre, duke përfshi zhavorin dhe punët	m <sup>2</sup>	20	1.00	20.00 €

tjera per montim				
			<b>Totali</b>	<b>70.00 €</b>

<b>3</b>	<b>PUNËT E DYSHEMESE NIVELUESE DHE NOTUESE</b>	Njesia	Sasia	€ /Njësi	€/Total
3.1	Furnizimi me material dhe betonimi i shtresës rrafshuese (Estrih) me përforcim e rrjete Ø4/15cm mbi pllakën e dyshemesë ne salle dhe korridorin lidhës (kuota ±0.00). Shtresa e Estrihut punohet me masë nga betoni i tharë në raport (rërë:çimento= 2:1), përfshirë fugmasen me Styropor d=30mm në takim me muret perimetrike dhe patenimi standard me makineri adekuate patenuese në sipërfaqe. Deformimi nuk guxon të jetë më e madhe se 4mm ne tere sipërfaqen. Ne çmimi te parashihet edhe izolimi me shtresat: -Folja PVC -Termizolim "Stirodur" t=5cm, -Folja Difuzive	m <sup>2</sup>	735	12.50	9,187.50 €
3.2	Furnizimi me material dhe punimi i dyshemesë elastik (sportive) te fushëlojës gome adekuate sportive te çertifikuar nga FIBA e cila duhet ti plotësoi kërkesat e standardit DIN V standard 18032-2; EN 14904, FIBA rules 2010, Kjo dysheme duhet te jete për terrene sportive te brendshme dhe të plotësojë të gjitha normat sportive dhe teknike te kërkuara sipas: IHF, FIBA dhe BËF dhe standardet teknike dhe kualitetit te certifikuara sipas DIN, ISO 9001, ISO 14001 . Dyshemeja te punohet edhe me këndore-lajsne perimetrike me sistem ajrim te montuara ne mure, mbulimi i pragjeve-dilatimeve me lajsne-fuge alumini. Ne çmim dhe montim te parashihen te gjitha punët e nevojshëm për kompletimin e kësaj dyshemeje me material dhe ekzekutim te punëve sipas standardeve te lartcekura.	m <sup>2</sup>	725	42.50	30,812.50 €
				<b>Totali</b>	<b>40,000.00 €</b>

<b>4</b>	<b>PUNËT E BRAVARISË</b>	Njesia	Sasia	€ /Njësi	€/Total
4.1	Furnizimi dhe montimi i derës se jashtme dy kriheshe nga Alumini termik sipas ISO ose DIN standardeve të prodhuesve "Alumil" (apo të ngjashëm). Profilet te jen me min. tri fusha/ura termike në profil. Pjesët/panelet mes profileve te mbushen nga llamarinina e alumini ne dy shtresa me termoizolim ne mes. Dera të pajiset me mekanizëm përkatës për hapje-mbyllje me dorëza kualitative, qelës dhe gomë perimetrike. I tërë pozicioni punohet dhe montohet sipas skemës se hapjeve/projektit. dim. 180x280cm	copë	2	75.00	150.00 €

				Totali		150.00 €
5	PUNËT E NDRYSHME	Njesia	Sasia	€ /Njësi	€/Total	
5.1	Furnizimi, punimi dhe montimi i konstrukcionit te mbulojes se pjeses lidhese te salles me shkollen, me lartesi te ndryshme nga profilet katrore dhe drejtkendeshe	kg	3250	1.45	4,712.50 €	
5.2	Furnizimi dhe montimi i plesigllasit 10mm i tejdukshem	m <sup>2</sup>	65	26.5	1,722.50 €	
5.3	Furnizimi dhe montimi i Kubëzave të betonit 15x15x6cm në trotuare. Ne çmim te parashihen furnizimi, planifikimi dhe ngjeshja e nënshtresës se kubëzave me tampon, fraksion 8 mm, t= 5cm, skajoret (50m') nga betoni 8x20x80xcm te vendosur me beton MB-20, mbushja e fugave me zhavorr te ime dhe te gjitha punët e nevojshme për këtë pozicion.	m <sup>2</sup>	70	19.5	1,365.00 €	
5.4	Furnizimi dhe montimi i konstrukcionit metalik per basketboll (lëvizës me rrota) me Tabelat siguruese dhe rrethin e koshit , mbështetja e rrethit te koshit ne Tabelat siguruese te jete me një mbrojtje te bute dhe rrjeta e koshit. Ne çmimi te parashihen te gjitha punët e nevojshëm për kompletimin e këtij pozicioni sipas Sistemin EN 1270.	copë	2	2,250.00	4,500.00 €	
5.5	Furnizimi dhe montimi i portave për futboll te vogël. Konstrukcioni i porta është nga tubet Ø140mm metalike te lyera me ngjyre metali ne shtresa. Portat te jen te pajisura me rrejtën e nga fijet e litarit. Ne çmimi te parashihen te gjitha punët e nevojshëm për kompletimin e këtij pozicioni sipas standardeve për futboll te vogël.	copë	2	450.00	900.00 €	
5.6	Shënimi i fushave sportive me ngjyra të ndryshme (adekuate) e cila përdoret për shënimin e trenit sportiv mbi parket. Te gjitha dimensione te punohen sipas standardeve për sportet adekuate. - vija e bardhë e trenit të futbollit , - vija e verdhë e trenit për basketboll. Llogarite ne cope për lloj te lojës/fushës (një futboll i vogël, një basketboll).	copë	2	395.00	790.00 €	
5.7	Furnizimi, punimi dhe montimi i "Tribunave" dy shkallësh për spektatore (nxënës) me konstrukcion metalik /tube 40x40x0.3mm pjesa ulëse me dërrase d=5cm te ankeruar ne konstrukcion mbajtës me bulona. Dërrasa te lyhet me llak pa ngjyre ne dy shtresa. Ne çmim te llogariten the gjitha punët e nevojshëm për kompletimin e këtij pozicioni. Llogariten ne metër gjatësi.	m'	35	95.00 €	3,325.00 €	
				<b>Totali</b>	<b>17,315.00 €</b>	

<b>A:</b>	<b>REKAPITULIMI I PUNEVE NDËRTIMORE</b>				
1	PUNËT PERGADITORE				775.00 €
2	PUNËT DEMOLUESE				70.00 €
3	PUNËT E DYSHEMESE NIVELUESE DHE NOTUESE				40,000.00 €
4	PUNËT E BRAVARISE				150.00 €
5	PUNËT E NDRYESHME				17,315.00 €
		<b>TOTALI</b>			<b>58,310.00 €</b>

<b>B:</b>	<b>HIDRANTI</b>
-----------	-----------------

<b>I</b>	<b>PUNIMET E HIDRANTEVE</b>				
Pos	Përshkrimi	Njesia	Sasia	€ /Njësi	€/Total
1.1	Gërmimi i dheut për hapjen e kanalit për vendosjen e tubave të ujësjellësit të hidrantit të jashtëm.	m <sup>3</sup>	20	1.50 €	30.00 €
1.2	Furnizimi dhe montimi i gypit në kanal në jashtëm nga materiali Alkaten për furnizimin e hidranteve të mbrendshme Ø63mm(2"). Në çmime të llogaritë edhe kyçja në pusin e shkolles, dhe të parashihen të gjitha pjesët e nevojshme fazonike për lidhjen e gypit	m'	50	14.50 €	725.00 €
		<b>Totali</b>			<b>755.00 €</b>

	<b>REKAPITULIMI I PUNEVE TË HIDRANTEVE</b>				
<b>I</b>	HIDRANTET E BRENDESHE				
	<b>TOTALI</b>				

<b>C:</b>	<b>ELEKTRIKA</b>
-----------	------------------

	<b>Kuadrot Shperndarese</b>				
Pos	Përshkrimi	Njesia	Sasia	€ /Njësi	€/Total
<b>I</b>	<b>KKSHE - Kuadri Kryesor Shperndare Elektrike</b>				
1.1	Furnizimi dhe montimi i tabelës Kryesore shpërndarëse elektrik të njehsorit (KKSHE). Me mbrojtje IP43, të jetë i punuar nga llamarinë me trashësi 2mm dhe e mbrojtur me ngjyrë të plastifikuar, me dimensione 600x600x200mm, me këto elemente:	copë	1	12.50 €	12.50 €
1.2	Furnizimi dhe montimi i ndërprerës trepolare me aftësi shkyqëse 16 kA dhe rrymë nominale të mbrojtjes 80A/63A. Ndërprësi ka mbrojtje termike dhe termomagnetike.	copë	2	8.00 €	16.00 €
1.3	Furnizimi dhe montimi i shkarkuesve të mbitensionit ZNO 0.5kV, 40kA, 4p.	copë	3	8.00 €	24.00 €

1.4	Materiali i imët përcjellës për lidhje (zbarra, përques P/F, papuqe, kleme, bulona, etj.)	Paushall	1	15.00 €	15.00 €
				<b>Totali</b>	<b>67.50 €</b>

<b>2</b>	<b>KSHE-Sa. Kuadri Shpërndarës Elektrik-Salla sportit</b>				
2.1	Furnizimi dhe montimi i tabelës shpërndarëse elektrike për Sallen e sportit (KSHE-Sa).Me mbrojtje IP43, per mbi mure 533x293x200, me këto elemente:	copë	1	12.50 €	12.50 €
2.2	Furnizimi dhe montimi i mbrojtjes diferenciale katërploare me rryma normale In=25A dhe rryma diferenciale Idn=0.03A .	copë	1	8.00	8.00 €
2.3	Furnizimi dhe montimi i siguresave automatike trepolare me karakteristike veprimi C për rryma nominale In=16A .	copë	1	5.00	5.00 €
2.4	Furnizimi dhe montimi i siguresave automatike njepolare 1P+N me karakteristike veprimi C për rryma nominale In=16A.	copë	3	5.00	15.00 €
2.5	Furnizimi dhe montimi i siguresave automatike njepolare 1P+N me karakteristike veprimi C për rryma nominale In=10A.	copë	2	5.00	10.00 €
2.6	Materiali i imët përcjellës për lidhje (zbarra, përques P/F, papuqe, kleme, bulona, etj.)	Paushall	1	15.00	15.00 €
				<b>Totali</b>	<b>65.50 €</b>

<b>3</b>	<b>Ndriqimi</b>				
3.1	Furnizimi transporti dhe montimi i shtyllës ndriqese te zingtuar qe realizohet me mbjellje me larteso H=4m, nje kraheshe duke perfshire kapakun siguresa, kabell lidhese (3x2.5mm) dhe materialin tjetër te nevojshem. Te llogaritet dhe montimi i bazamentit MB 30 me gypa te brinjzuar+armatura e nevojshme per shtylla vertikale konike te zingtuara (0.6x0.6x0.8) m.	copë	6	455.00	2,730.00 €
				<b>Totali</b>	<b>0.00 €</b>

2,730.00 €

<b>C:</b>	<b>ELEKTRIKA</b>				
1	Kuadrot Shperndares				67.50 €
2	KSHE-Sa. Kuadri Shpërndarës Elektrik				65.50 €
3	Ndriqimi				2,730.00 €
				<b>TOTALI</b>	<b>2,863.00 €</b>

<b>D:</b>	<b>MAKINERIA</b>
-----------	------------------

Pos	Përshkrimi	Njesia	Sasia	€ /Njësi	€/Total
1	<b>SALLA E KALDAJES</b>				

1.1	Germimi i dheut hapja e kanalit per vendosjere gypave te çelikut të izouar me llamarin me lesh guri , duke perfshirë edhe zhavorin per mbulimin e gypit.	m'	54.5	1.50	81.75 €
1.2	Furnizimi dhe montimi i gypit te galvanizuar 2" i cili duhet të jetë i izoluar me lesh guri dhe llamarinë	m'	109	19.50	2,125.50 €
1.3	Furnizimi me material percjelles si gaz salldimi, berrylla, elektroda, dhe tegjitha punet e nevojshme per kompletimin e pozicioneve deri ne lidhjen ne kaldan ekzistuese.	copë	1	150.0 0	150.00 €
1.4	Çajrosje automatike 3/4	copë	2	15.00	30.00 €
	<b>Instalimi i pompës/ngrohjes duhet te kyçet ne kaldane ekzistuese te shkollës (nëse kaldaj nuk është funksionale te lihen te gjitha pjesët e nevojshëm për kyçje). Ky pozicion te konsultohet paraprakisht me mbikëqyrësin dhe menaxherin e shkollës. Ne çmim te parashihet, furnizimi, montimi, punimi dhe testimi i te gjitha pozicioneve te nevojshëm.</b>				0.00 €
1.5	Pompa prodhim "GRUNDFOS" (apo ekuivalent) UPS 50 30 F Hop.=2.4 (m) Qop.=0-16 (m³/h) DN 50	copë	2	475.0 0	950.00 €
1.6	Valvol me flanxhe prodhim "ARI ARMATUREN" (apo ekuivalent) DN 50 PN 6 (apo prodhues te tjere me qualite dhe karakteristika te ngjajeshme)	copë	5	165.0 0	825.00 €
1.7	Mbledhës i papastertive prodhim "ARI ARMATUREN" (apo ekuivalent) DN 50 PN 6 (apo prodhues te tjere me qualite dhe karakteristika te ngjajeshme)	copë	1	75.00	75.00 €
1.8	Amortizues i dridhjeve "ARI ARMATUREN" (apo ekuivalent) DN 50 PN 7	copë	4	5.00	20.00 €
1.9	Kolektor shpërndarës Ø 168.3 x 2000 mm	copë	1	12.50	12.50 €
1.1	Kolektor permbledhes Ø 168.3 x 2000 mm	copë	1	12.50	12.50 €
1.11	Manometër i drejt 0 44 bar (R1/2- 100 mm)	copë	4	10.00	40.00 €
1.12	Termometër i drejt 0-120 OC (R1/2- 100 mm)	copë	4	20.00	80.00 €
1.13	Termometër kendor 0-120 OC (R1/2- 100 mm)	copë	1	10.00	10.00 €
1.14	Termomanometër këndor	copë	1	10.00	10.00 €
1.15	Valvol për zbrazje – mbushje 1"	copë	3		13.50 €

				4.50	
1.16	Gyp i çelikut DN 20	m	18	1.50	27.00 €
1.17	Gyp i çelikut DN 25	m	12	1.85	22.20 €
1.18	Gyp i çelikut DN 50	m	46	2.25	103.50 €
1.19	Mbajtesa per gypa prej metali	copë	30	2.00	60.00 €
		<b>Totali</b>			<b>4,648.45 €</b>

2	PJESA E BRENDSHME E SALLES	Njesia	Sasia	€ /Njësi	€/Total
	Furnizimi dhe montimi i radiatorve të tipit panel prodhim "Fabrika e radiatoreve"- Gjilan apo prodhues te tjere me qualite dhe karakteristika te ngjajeshme.				
2.1	22-600/1800	copë	2	12.50	25.00 €
2.2	Furnizimi dhe montimi i kalorifereve model: "SFC2-5K"	copë	8	615.00	4,920.00 €
2.3	Valvole per kalorifer 1" komplet prodhim "GIACOMONI" -Itali	copë	16	15.00	240.00 €
2.4	Holander per lidhjen e kalorifereve 1"	copë	16	15.00	240.00 €
2.5	Valvola sistemit njëgypor prodhim "GIACOMONI" - Itali, Model R436TG R436X052	copë	2	3.50	7.00 €
2.6	Valvol automatike per qajrosje ½"- "GIACOMONI" - Itali	copë	12	10.00	120.00 €
2.7	Mbajtëse të radiatorve panel	copë	4	2.20	8.80 €
2.8	Kaseta shperndarese 40x45 cm	copë	1	25.00	25.00 €
2.9	Kolektor shperndares 2x16x1"- "GIACOMONI" -Itali Kolektor dyshe R585T dhe njeshe R585M	copë	2	6.50	13.00 €
2.10	Tapa kolektori 1"- "GIACOMONI" -Itali, R592D	copë	1	1.50	1.50 €
2.11	Çajrosje automatike komplet me valvol per zbrazje prodhim- "GIACOMONI" -Itali, R554B	copë	1	3.50	3.50 €
2.12	Valvol sferike me holander 1"x 1"- "GIACOMONI" - Itali R259D R259X007	copë	2	2.20	4.40 €
2.13	Lidhese gyp radiator - "GIACOMONI" -Itali	copë	4	1.20	4.80 €
2.14	Lidhese gyp kolektori - "GIACOMONI" -Itali	copë	4	1.20	4.80 €
2.15	Gypë Cu i plastifikuar Ø15x1 mm, prodhim "ISOCLIMA"-Isoplus	m	100	0.85	85.00 €
2.16	Gypë Cu Ø 28 x 1.5 mm prodhim "ISOCLIMA"-Itali ose prodhim i ngjashëm nga prodhimet e Bashkësisë Evropianë	m	6	1.25	7.50 €

2.17	Izolimi i gypave F 28 x 2 mm te vertikaleve kryesore si dhe kolektoreve shpërndares në sallën e kaldajës me izolim armafleks si dhe folie te aluminit	m	12	2.20	26.40 €
2.18	Gyp i çelikut DN 25	m	126	2.20	277.20 €
2.19	Gyp i çelikut DN 32	m	78	7.50	585.00 €
2.20	Gyp i çelikut DN 40	m	66	9.50	627.00 €
2.21	Gyp i çelikut DN 50	m	88	1.25	110.00 €
2.22	Punët e materialit shpenzuese (te imët) si: bërryla, reduktuese, vazhduese, t-element etj., Izolimi i gypave te çelikut deri te vertikalet me izolim armafleks dhe te gjitha pune e nevojshëm për kompletimin e pozicionit 2.	copë	1	155.00	155.00 €
2.23	Depërtimi i vrimave dhe kalimi i detalit ne sistemin "gypi në gypë", përgatitja e dhe hapja e mureve për vendosjen e kasetave, pastrimi dhe ngjyrosja e gypave, shqyrtimi i instalimit ne ujë te ngrohtë dhe te ftohte me te gjitha pune e nevojshëm për këto aktivitete punuese.	copë	4	10.00	40.00 €
				<b>Totali</b>	<b>7,530.90 €</b>

3	VENTILIMI	Njesia	Sasia	€ /Njësi	€/Total
3.1	Ventilator i Thithjes TD A 20/20 3CV III F me fuqi V=12500 (m <sup>3</sup> /h)	copë	1	850.00	850.00 €
3.2	Ventilator i Prurjes TD A 20/20 3CV III F me fuqi V=12500 (m <sup>3</sup> /h), me kembyes te nxehtesise	copë	1	850.00	850.00 €
3.3	Punimi i kanaleve nga llamarinë e zinguar me trashësi 0.5 ....1.0 mm	kg	1650	3.50	5,775.00 €
3.4	Pjesët fazonike për kanale është 10% nga pozicioni 3.3	%	0.10	5,775.00	577.50 €
3.5	Izolimi i kanaleve për prurjen e ajrit dhe kanalet me armafleks "Armacell" me trashësi 13mm	m <sup>2</sup>	90	6.50	585.00 €
3.6	Konstrukcioni mbajtës i ventilatoreve	cca	1	45.00	45.00 €
3.7	Kembyesi kanalore me Q= 50 kË	copë	1	45.00	45.00 €
3.8	Amortizues i zhurmës	m	6	5.00	30.00 €
3.9	250 x 650 [mm]	copë	2	35.00	70.00 €



3.10	Anemostatetose Prodhim S&P - Spanje (apo prodhues te tjere me kualitet te nrrjet) me rregullatorte prurjes dhe Kutin per montim: 457x547mm	copë	30	75.00	2,250.00 €
3.11	Material hargjues si flanaxhe, këndore, bulona me dado, izolim për lidhje etj 5 % prej 3.1-3.9 dhe shqyrtimi i instalimit/rrjetit.	copë	0.05	8,827.50	441.38 €
<b>Totali</b>					<b>11,518.88 €</b>

<b>D:</b>	<b>REKAPITULIMI MAKINERIA</b>				
1	SALLA E KALDAJES				4,648.45 €
2	PJESA E BRENDSHME E SALLES				7,530.90 €
3	VENTILIMI				11,518.88 €
<b>TOTALI MAKINERIA:</b>					<b>23,698.23 €</b>

	<b>REKAPITULIMI I PERGJITHESHEM</b>				
A	PUNËT NDËRTIMORE DHE ZEJTARE				58,310.00 €
B	HIDRANTI DHE DRENAZHA				755.00 €
C	ELEKTRIKA				2,863.00 €
D	MAKINERIA				23,698.23 €
<b>TOTALI ME TVSH:</b>					<b>85,626.23 €</b>

### NDERTIMI I OBORRIT TE SHKOLLES NE SHKOLLEN "MIGJENI" - RUFÇI I RI

**LOKACIONI: RUFÇI I RI/LIPJAN**

**INVESTITORI: KUVENDI KOMUNAL LIPJAN**

VËREJTJE:

Materialet e propozuara në përshkrim teknik dhe paramasë janë opcionale dhe pikë referimi për karakteristikat e materialeve që duhet të përdoren andaj të gjitha ato mund të zëvendësohen me materiale të prodhuesve tjerë me karakteristika të njëjta ose më të mira që duhet dëshmuar me certifikatat apo atestet e ofruara nga prodhuesit respektiv. Në të gjitha pozicionet përfshihet FURNIZIMI DHE MONTIMI/PUNIMI I ATIJ POZICIONI. TEK PASTRIMET, DEMOLIMET E GERMIMET TE PERFSHIHET EDHE TRANSPORTI DERI NE DEPONI.

<b>I PUNËT NDËRTIMORE</b>					
<b>1.01 PUNËT PARAPREGADITORE DHE DEMOLUESE</b>					
<b>POS</b>	<b>PËRSHKRIMI I PUNËVE</b>	<b>NJËSIA</b>	<b>SASIA</b>	<b>ÇMIM I/NJË SI</b>	<b>SHUMA</b>
1.01.01	Rrethimi dhe sigurimi i punishtes me konstrukcion metalik dhe llamarinë të zinkuar me lartësi 2 m në tërë perimetrin e caktuar të punishtes dhe shënjëzimi informativ me tabelën Informuese me dimensione 1.5x2 m të punuar nga profilet e hekurit dhe llamarina.	m'	200	1.50 €	300.00 €

1.01.02	Organizimi i punishtes dhe depove, furnizimi me material dhe ndërtimi i rrjetit të përkohshëm të ujësjellësit, kanalizimit, rrjetit elektrik dhe ndriçimit të kantierit, vendosja e kontejnerit për zyrën e menaxhimit të projektit dhe vendosja e EC kabinave për nevojat e punëtorëve.	komple t	1	50.00 €	50.00 €
1.01.03	Pozicionimi gjeodezik dhe shënjëzimi i strukturave për ndërtim.	komple t	1	50.00 €	50.00 €
<b>TOTAL POZICIONI</b>				<b>1.01</b>	<b>400.00 €</b>

<b>1.02 PUNËT E DHEUT DHE ZHAVORIT</b>					
<b>POS</b>	<b>PËRSHKRIMI I PUNËVE</b>	<b>NJËSIA</b>	<b>SASIA</b>	<b>ÇMIMI/NJËSI</b>	<b>SHUMA</b>
1.02.01	Gërmimi i shtresës së humusit dhe dheut me trashësi 30 cm në tërë sipërfaqen e paraparë për pozicionimin e lodrave të femijeve. Në çmim duhet të përfshihet edhe transportimi i dheut të gërmuar deri në deponinë e përcaktuar nga autoritetet komunale në distancë deri 10 km. <b>Vërejtje:</b> Sasia e shënuar paraqet vëllimin e ngjeshur ku nuk është marrë parasysh koeficienti i shkurtësisë. Vërejtje: Një sasi e dheut duhet të mbetet në punishte për mbushjet eventuale dhe modelimin e oborrit.	m <sup>3</sup>	69.00	2.50 €	172.50 €
1.02.02	Gërmimi i shtresës së humusit dhe dheut me thellësi 80 cm në tërë sipërfaqen e paraparë për pozicionimin e shputave të rrethojës metalike të fushës, dimensionit të sipërfaqes a/b=90x90 cm. Në çmim duhet të përfshihet edhe transportimi i dheut të gërmuar deri në deponinë e përcaktuar nga autoritetet komunale në distancë deri 10 km. <b>Vërejtje:</b> Sasia e shënuar paraqet vëllimin e ngjeshur ku nuk është marrë parasysh koeficienti i shkurtësisë. Vërejtje: Një sasi e dheut duhet të mbetet në punishte për mbushjet eventuale dhe modelimin e oborrit.	m <sup>3</sup>	13.00	3.50 €	45.50 €
1.02.03	Furnizimi me material dhe punimi i tamponit nga zhavorri me trashësi 20 cm me fraksion 0/31 në tërë gjerësinë e sipërfaqes së shputës, perimetrin rreth sajë me të njëjtën trashësi duke përfshirë edhe nivelimin dhe ngjeshjen me mekanizëm deri në arritjen e kompaktësisë Ms=30 MPa. <b>Vërejtje:</b> Për shkak të pasaktësive gjatë punës dhe mundësisë së humbjes së materialit në shtresën e dheut sasija e llogaritur është rritur për 50%	m <sup>3</sup>	10.00	22.00 €	220.00 €
<b>TOTAL POZICIONI</b>				<b>1.02</b>	<b>438.00 €</b>

<b>1.03 PUNËT E BETONIT</b>					
<b>POS</b>	<b>PËRSHKRIMI I PUNËVE</b>	<b>NJËSIA</b>	<b>SASIA</b>	<b>ÇMIMI/NJËSI</b>	<b>SHUMA</b>

<p><b>VËREJTJE</b>  Punë kryesi është i obliguar që të marr mostrat e betonit për çdo 'parti' betoni, të kujdeset për mirëmbajtjen e tyre, dërgimin në laboratorë të specializuara për shqyrtimet e nevojshme dhe sigurimin e raporteve përkatëse për të gjitha mostrat.</p> <p><b>VËREJTJE</b>  Për pozicionet e parapara të betonohen me shtesa të specifikuara si më poshtë punë kryesi obligohet që të veprojnë sipas udhëzimeve të prodhuesit duke ju përmbajtur reçetës së përzierjes, duke respektuar raportet e përzierjes ujë-çimento-agregat ndërsa aditivet e kërkuara duhet të shtohen në mikser pas ardhjes në punishte në praninë e organit mbikëqyrës.</p>					
1.03.01	Furnizimi me material dhe punimi i bazës për mbështetjen e elementeve të lidhura të armaturës së themeleve themeleve të veçuara. Betonimi të bëhet me beton të varfër të markës c-16/20 me trashësi min.5 cm mbi tamponin e zhavorit, duke përfshirë edhe nivellimin horizontal. Gjerësia e betonimit të jetë së paku nga 10 cm më e gjerë në të dy anët e shputës së themeleve.	m <sup>3</sup>	0.40	115.0 0 €	46.00 €
1.03.02	Furnizimi me material dhe betonimi i shputave sipas projektit. Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30 me aditiv kristalor për arritjen e pa depërtueshmërisë nga uji, në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit. <b>VËREJTJE:</b> Tek muret e themellit në pjesë të caktuara njëkohësisht duhet betonuar edhe konzollën me trashësi 20 cm për mbështetjen e fasadës së tullave.	m <sup>3</sup>	3.00	115.0 0 €	345.00 €
<b>TOTAL POZICIONI</b>				<b>1.03</b>	<b>391.00 €</b>

<b>1.04</b>	<b>PUNËT E ARMIMIT</b>				
<b>POS</b>	<b>PËRSHKRIMI I PUNËVE</b>	<b>NJËSIA</b>	<b>SASIA</b>	<b>ÇMIM I/NJË SI</b>	<b>SHUMA</b>
	Furnizimi me material, prerja, lakimi dhe lidhja e armaturës për formimin e elementeve të armaturës së brinjëzuar sipas planeve dhe specifikimeve të armaturës. Të gjitha armaturat duhet të jenë të kualitetit B500B, sipas standardit EN-10080 dhe duhet jenë të pastra nga korozioni. Në çmim të përfshihet përdorimi i distancerave të llojeve të ndryshme në varësi të pozicionit me qëllim të arritjes së trashësisë së duhur të shtresës mbrojtëse.				
1.04.01	Ø 8, 10, 12, 14,16, 20	kg	270.00	1.00 €	270.00 €
<b>TOTAL POZICIONI</b>				<b>1.20</b>	<b>270.00 €</b>

<b>1.05</b>	<b>PUNËT E PARTERIT DHE FUSHËLOJAVE</b>				
<b>POS</b>	<b>PËRSHKRIMI I PUNËVE</b>	<b>NJËSIA</b>	<b>SASIA</b>	<b>ÇMIM I/NJË SI</b>	<b>TOTAL</b>
